



PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) - Rahovec, e mbajtur më 16.03.2023, me fillim në ora 15:00. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës Smajl Latifi. Kuorumi për mbajtjen e mbledhjes është. Kryetari - Më lejoni t'i përshëndes anëtarët e KKSB-së, përshëndes nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, drejtorët e drejtorive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovec z. Fazli Morina, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e OSBE-së, LMT-së, FSK-së, udhëheqësin e Sektorit të Kuvendit, Skenderin, shefin e kabinetit dhe mediat. Është mbledhja e dytë e rregullt për vitin 2023. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

Rend Dite

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Trotuaret, lirim i tyre dhe shenjat sinjalizuese;
 - Qentë endacak;
 - Siguria në trafik;
 - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e Planit për Siguri në Shkolla;
 - Veprimi dhe masat për luftimin e shkelësve të ligjit në Komunën e Rahovecit;
 - Mbrotja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit;
 - Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore;
3. Organizimi i Takimit Publik me qytetarë dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane;
4. Të ndryshme.

Kryetari – Përshëndetje për të gjithë, paraprkishtë e keni marrë rendin e ditës dhe e keni në material. A ka dikush ndonjë koment, vërejtje apo shtesë?... Nëse jo, atëherë kush është “për”?... kundër?... Abstenime?... Faleminderit, konstatojmë se rendi i ditës kalon.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryetari – A ka komente, këshilla apo vërejtje për procesverbalin që e kemi të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë kush është “për” miratimit?... votë kundër a ka?... Abstenime?... Konstatojmë që është miratuar procesverbali.

2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Rahovecit;

Kryetari – Gjendja e përgjithshme në Komunën e Rahovecit në bazë të argumenteve dhe burimeve tona të disponueshme, është e qetë, stabile dhe e qëndrueshme. Në periudhën në mes dy mbledhjeve nuk ka pasur situata të cilat e kanë cenuar sigurinë e përgjithshme në Komunën e Rahovecit. Sot ka filluar një stërvitje ushtarake e KFOR-it Austriak me lëvizje të helikopterëve dhe makinerive të rënda ushtarake. Kjo nuk është për t'u shqetësuar, sepse është vetëm një plan për ushtrime rutinore, e kemi edhe njoftimin publik që e ka bërë komuna. Sa i përket punishteve në qytet, në qendër është duke u hapur një kanal për futjen e kablllove elektrike nëntokë. Gjatë punimeve, mundohemi të mos kemi bllokim të qarkullimit të automjeteve në trafik, duke gjetur rrugë alternative për t'u evituar pengesat e qarkullimit në qytet. E kemi edhe një punishte të re, te Sheshi Qëndror në Park Plaza, ku po vazhdojnë punimet në gërmimin për nevojat e ndërtimit të parkingut nëntokësor dhe mbi tokësor. Gjatë kësaj periudhe mund të ketë më shumë sinjalizues në rrugë për orientim më të qartë. Jemi në procedurë finale sa i përket trajtimit të qenëve endacakë në komunën tonë. Në mungesë të një plani

kombëtar, i kemi ndarë 100.000 euro për tre vite dhe gjatë kësaj periudhe do të kemi vazhdimësi të trajtimit të qeneve endacakë.

Mbrojtja e lumenjve që rrjedhin në territorin e Komunës së Rahovecit dhe Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore, janë dy pika standarde që do të ballafaqohemi në çdo takim të KKSB-së. I kemi me prioritet këto detyrime që t'i mbrojmë lumenjtë dhe përrenjtë nga ndotja dhe hedhja e gjësendeve duke dërguar një mesazh të qartë që nuk do të ketë kompromis për ata që hedhin mbeturina në lumë. Te siguria dhe kontrolli i ushqimeve, inspektoriati jonë ka hetuar që ka mallra

ushqimore me afat të skaduar dhe kanë shqiptuar gjoba për dy-tri kompani të qendrave tregtare dhe nuk do të heqim dorë nga përpjekja intenzive në këtë aspekt hulumtimi. Siguria dhe kontrolli i produkteve ushqimore është prioritet i lartë i komunës së Rahovecit.

Fazli Morina - I nderuar kryetar, të nderuar pjesëtarë të FSK-së, të bashkësive fetare dhe ju të gjithë anëtarë të KKSB-së. Gjendja e sigurisë konsiderohet e qetë dhe stabile. Kanë ndodhur 102 vepra penale, 17 incidente jopenale. 4 lëndime të lehta, vjedhje 5 raste, 8 raste të dhunës në familje, 2 raste të narkotikëve, konfirmim të armëve 12 raste, 7 raste urdhër kontrolli.

Janë arrestuar për mbajtje 48 orë 16 persona, raste të huliganizmit 2 raste, të dëmtimit të pasurisë 7 sosh (në palestër me rastin e organizimit të kupës Final 8).

- Sa i përket sigurisë në komunikacion rrugor;

Janë dhënë 1431 gjoba në komunikacion rrugor.

- Rreth sigurisë në shkollë, janë bërë 142 vizita.

Prej shkollave janë raportuar 5 raste (sulm, asgjësim i pasurisë, lëndim i lehtë trupor).

Shaip Shala – Përshëndetje kryetar, kolegë të pranishëm. Sa i përket këtij problemi, e kam paralajmëruar drejtorin Përparim dhe drejtoreshën e nderuar Norën. Është fjala për largimin e një kontenjeri afër Petrol Company (tek muri i familjeve Shehu), të cilët e kanë larguar kontenjerin në drejtim të panjohur (për arsye të parkingut të makinave). Është shqetësim i lagjes, sepse në gjatësi prej 700 metrave nuk është asnjë kontenjer. Një fjalë rreth raportit të komandantit; A është zhdukur narkomania në shoqëri në Komunën e Rahovecit apo është në luftim?... Lokalet e natës në Xërxë, a janë qetësuar?... Faleminderit.

Fadil Sylka – Përshëndetje kryetar. Pyetja e parë: Rreth punimeve në qendër, kur e kanë afatin kohor kur përfundojnë ato punime?... Kontrata është me penale, apo pa-penale, sepse në rast vonesës së punimeve, atëherë pëson operatori i cili vepron, do të ishte mirë që kontrata të jetë me penale. Pyetja e dytë: Rreth materialeve të ngurta – hedhjeve. A ekziston baza ligjore dhe të bëhet një kompani për bartjen e materialeve të ngurta (me pagesë), e cila më pas ta bën reciklimin e materialeve. Do të ishte një vendim i mirë për qytetarët.

Lulzim Krasniqi – Përshëndetje kryetar! Rreth temës së mbrojtjes së lumenjve; Po filloj me një konstatim timin të realizuar në 2015 me një projekt amerikan për këtë çështje. “A thu a po n’a hakmerret natyra për veprimet tona të gabuara, apo për mosveprimet për parandalimin e pasojave nga vërshimet”. Reshje ka do të ketë çdo herë, por ajo çfarë duhet të bëjmë është që t'i mbrojmë rrjedhat ujore nga mbeturinat me studime inxhinierike të bazuara në të dhëna hidrologjike shumëvjeçare. Konstatoj që si propozim-zgjidhje mund të jetë: Parandalimi i ndërtimeve pa leje, realizimi i mirëfillt i Planit Urbanistik, zgjerimi i shtretërve, mbajtja e ligjeratave sensibiluese, ndalimi hudhjes së mbeturinave dhe shqiptimi i masave të rrepta ndaj atyre që degradojnë.

Fazli Morina – Faleminderit Shaip. E kam lexuar shkresën sa i përket largimit të kontejnerit atje. Kjo gjë nuk është kompetencë e jona fare hiç, besoj që kryetari do ta plotëson këtë. Sa i përket narkomanisë, mund të ketë edhe rritje, por jemi duke punuar në këtë drejtim me njësitë tona dhe ato të specializuara për narkotikë.

Nora Boshnjaku – Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të pranishmit në KKSB. Sa i përket pyetjes së z. Shaip Shala: Personi në fjalë është i familjes Shehu, i cili e ka larguar individualisht kontejnerin. Ne i kemi

ndërmarrë të gjitha masat dhe është pranuar që kontejneri të kthehet në hapësirën ku caktohet nga Drejtoria e Urbanizmit, Inspektoriatit dhe Shërbimeve Publike. Sa i përket lokaleve të natës, i kemi zhvilluar disa aksione dhe kemi shqiptuar gjoba për mosrespektim të orarit të punës. Sa i përket ndotjes së mjedisit deri më tani kemi shqiptuar mbi 50 gjoba mandatore. Do të vazhdojmë tutje kundër degradimit të lumenjve në hudhjen e mbetjeve shtazore dhe mbeturinave tjera të ndryshme.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë. Sa i përket deponisë legale të mbeturinave, kemi filluar me procedurën e ankandit publik. Kompania që do ta menaxhojë atë, do ta bëjë nda ndarje të mbeturinave dhe ka hapësirë prej 3 ha. Planifikimi i sheshit në qendër është deri më 15 prill, është një punë komplekse ku do të trajtohen gypat nëntokësor duke përfshirë edhe rrjetin elektrik. Sa i përket përrockave; jemi në një fazë ku jemi duke e bërë pastrimin e tyre rreth 10 km që janë me urgjencë për pastrim.

Erhan Morina – Faleminderit kryetar! Të nderuar anëtarë të KKSB-së. Projekti në qendër ka filluar në gusht të vitit që shkoi. Arsyeja e vonesave në këtë projekt ka qenë sistemimi i kablllove, ndriçimit publik dhe të tensionit nën tokë. Aktualisht janë duke vazhduar punimet për devijimin e lumit “Duhillo”. Më së largu deri në fund të muajit prill do të përfundojnë punimet e sheshit.

Avni Morina – Faleminderit kryetar! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KKSB-së. Ne jemi në pranim të raporteve sistematike nga stacioni policor në Rahovec, për të gjitha aktivitetet e policisë nëpër shkolla dhe për të gjitha rastet që ndodhin në ambientet shkollore.

Kryetari – Faleminderit të gjithëve për kontributin. Sa i përket pikës së dytë, telegrafikisht do t'i nxjerri disa përfundime rreth pikës së dytë. U diskutuar rreth huliganizmit me rastin e organizimit të Final 8, natyrisht e kemi mirëpritur këtë ngjarje të madhe sportive, por asnjëherë nuk do t'i mirëpresim këto gjëra që kanë të bëjnë me dhunën në sport duke shkaktuar dëme. Sa i përket dhunës në familje, i inkurajoj OJQ-të, Qendrën për Punë Sociale dhe grupin joformal të grave, që të punojnë më shumë rreth fushatës së ndërgjegjësimit. Veprimet e ndeshura me ligjin do të kenë gjoba mandatore, duke kërkuar ndihmën e KKSB-së dhe policisë.

Sa i përket sigurisë në shkolla, ne kemi mandat që t'i marrim të gjitha masat dhe veprimet për sigurinë e tyre në pajtim me ligjin. Te lokalet e natës, kërkoj nga inspektoriatit dhe policia që t'i shumëfishojnë aksionet. Në ora 23:00, sipas vendimit të kryetarit të komunës, përfundon aktiviteti dhe puna në lokalet “problematike” të natës. Sheshi në qendër është kontratë dy vjeçare, d.m.th deri më 31 dhjetor, por ne do të synojmë ta përfundojmë në fund të muajit prill. Duke mos e keqpërdorur hapësirën publike me automjete dhe me uzurpime, në fund do të del një shesh shumë i mirë. Sfidë për Komunën e Rahovecit janë edhe ndërtimet pa leje sepse nëse nuk arrin të bartet trashëgimia, atëherë nuk mund të pajiset me leje. Sa i përket vërshimeve, nuk parashihet të kemi, tani e tutje me punën që po bëjmë nuk llogaritet që lumi “Duhillo” të del nga shtrati. As Fortesa nuk parashihet të ketë telashe. Te mbeturinat: Përkundër gjobave mandatore, përsëri njerëzit e pandërgjegjshëm vazhdojnë të hudhin mbeturina duke e ndalur rrjedhën e lumenjve. Një rol dhe peshë të madhe në parandalimin e këtij fenomeni e kemi edhe ne si KKSB, sepse mjedisi është prioritet i lartë i punës dhe me ligjërata sensibilizuese dhe objektivat e KKSB-së, mund ta minimizojmë degradimin e lumenjve.

3. Organizimi i Takimit Publik me qytetarë dhe kryetarët e fshatrave dhe lagjeve urbane;

Kryetari – Ky takim duhet të mbahet brenda një afati optimal me plan vjetor. E kemi një hendipet në mosinteresim, që 3-4 fshatra ende nuk i kanë zgjedhur kryetarët e tyre. Detyra e Skender Hamzës si udhëheqës i Sektorit të Kuvendit do të jetë ta organizojë këtë takim, ku janë të ftuar edhe anëtarët e KKSB-së.

4. Të ndryshme;

Shaip Shala – Uroj sheshi që do të jetë fantastik, do ta gëzoj sheshit duke u shëtitur në të. Po më dhimbset prishja e fushës së futbollit sepse kam 60 vite që jetoj me të, por nuk kam çfarë të bëj, sepse tani dinamika e punimeve dhe e jetës ka evoluar. Kur u përmend roli i anëtarit të KKSB-së, personalisht e marr rolin e policit në komunitet.

Kryetari – Faleminderit, meqë është afër Ramazani, urime atyre që agjërojnë, shëndet.

Bujar Morina – Përshëndetje për të gjithë. Rreth këndit të dëmtuar afër “Viva Freshit” dhe një lutje për riparim. Aty duhet ta parandalojmë ndonjë aksident të mundshëm, sepse shoh shumë fëmijë duke lozur.

Kryetari – E ftoj inspektoriatin që t’ia tërheq vërejtjen atij që është me “autolarje” aty, i cili po e shfrytëzon edhe hapësirën që nuk i takon. Sa i përket riparimit, Përparimi është mirë të kujdeset rreth kësaj.

Sabahudin Durguti – Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë. Më vie shumë mirë që na uruat agjërimin e Ramazanit, por, më duket se çdo vit po harroni të na uroni Sulltan Nevruzin.

Kryetari – Unë çdo vit e uroj edhe Sulltan Nevruzin dhe i bën të fala sheh Mehdiut dhe të tjerëve.

Milan Stanojeviq – Faleminderit kryetar. Gjithashtu edhe unë uroj të gjithë besimtarëve Muajin e Ramazanit. Paraprakisht falënderoj drejtorin Përparim për përgjigjen e kthyer lidhur me realizimin e projekteve në lagjen e epërme. Një kërkesë për kryetarin e komunës në lidhje me regjistrimin e popullsisë që planifikohet të mbahet në shtator – tetor. Kërkoj nga kryetari që të gjithë komunitetet pakicë të përfshihen në këtë regjistrim si dhe të integrohet me punë në terren edhe komuniteti serb gjatë regjistrimit.

Kryetari – Faleminderit për urimin. Çdo herë e kemi pasur parasysh që çdo komunitet të marrë pjesë në këtë fazë të regjistrimit të popullsisë. Të ftoj ta inkurajosh komunitetin serb në këtë aspekt. Faleminderit të gjithëve për angazhimin, shihemi në mbledhjen e ardhshme. Mirëmbetshi.

Mbledhja përfundoi në ora 16:35

Procesmbajtësi

Albion Krasniqi

Kryetari i Komunës

Samir Latifi

